



Save the Children

Numri dhe Koha e Vizitave të Kujdesit Para Lindjes



Gjatë shtatzënisë së parë, gruaja shtatzënë duhet të kryejë 10 vizita tek mjeku, ndërsa gjatë shtatzënieve të tjera kryhen 7 vizita.¹

1. Protokoll i Kujdesit Antenatal

Ky material është prodhuar dhe publikuar në kuadër të projektit:

“Aksesi në shërbimet shëndetësore dhe të ushqyerjes për fëmijët dhe gratë e moshës riprodhuese në Tiranë”, që mbështetet dhe zbatohet nga Save the Children.

Save the Children

Rr: “Komuna e Parisit”, Lagjia 8,
Pallatet 1 Maji, Vila “Lami”: P.O. Box 8185
Tiranë - Shqipëri

Tel: +355 4 2261840 / 2261929

E-mail: info.albania@savethechildren.org
<https://albania@savethechildren.net>



Savethechildrenal



SaveChildrenAlb

Tremujori i parë - Nga fillimi i shtatzënisë deri në javën e 12 të shtatzënisë

Vizita e parë duhet të kryhet sa më herët që dyshohet shtatzënia – deri në javën e 10 të shtatzënisë.

Vlerësohet shtatzënia dhe shëndeti i nënës.

- Matja e gjatësisë, peshës dhe përcaktimi i indeksit të masës trupore
- Matja e tensionit të gjakut
- Analiza e urinës së thjeshtë, urokultura
- Analiza për grupin e gjakut, faktori Rhesus
- Analiza për anemi, talasemi
- Analiza e glicemisë (sheqeri në gjak)
- Analiza për disa viruse, si hepatiti B, HIV, Rubeola
- Ekzaminimi me ekografi për të përcaktuar moshën e shtatzënisë
- Ekzaminimi për sindromën Down

Tremujori i dytë - Nga java e 12 deri në javën e 28 të shtatzënisë

Gjatë këtij tremujori të shtatzënisë duhet të kryhen vizita:

- në javën e 10 – 16
- në javën 18 – 20
- në javën e 25

Shqyrtohen analizat e dhëna dhe bëhet vlerësimi

- Matja e peshës
- Matja e tensionit të gjakut
- Analiza e urinës
- Analiza e gjakut komplet, për anemi dhe antitrupe
- Analizat e glicemisë (sheqeri në gjak) azotemisë, kreatinemisë, uricemisë, fibrinogjenit, hekurit TORCH, HBsAg
- Ekzaminimi me ekografi për të përcaktuar anomali, zhvillimin e fetusit apo numrin e tyre

Tremujori i tretë - Nga java e 28 e shtatzënisë deri në javën e 40 të shtatzënisë

Gjatë këtij tremujori të shtatzënisë duhet të kryhen vizita:

- në javën e 28
- në javën e 31
- në javën e 34
- në javën e 36
- në javën e 38
- në javën e 40

Shqyrtohen analizat e dhëna dhe bëhet vlerësimi

- Matja e peshës
- Matja e tensionit të gjakut
- Analiza e urinës
- Analiza e gjakut komplet, për anemi dhe antitrupe
- Analizat e glicemisë (sheqeri në gjak) azotemisë, kreatinemisë, uricemisë, fibrinogjenit, hekurit TORCH, HBsAg
- Ekzaminimi me ekografi për të përcaktuar anomali, zhvillimin e fetusit apo për të vlerësuar pjekurinë e placentës